

GJYKATA E QARKUT MITROVICË
K. Nr. 244/2007
05 maj 2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare, dhe nga gjyqtarët e EULEX-it Klaus Jung dhe Nikolay Entchev si anëtarë, me pjesëmarrje të Zyrtarit ligjor të EULEX-it Francesco de Sanctis si procesmbajtës, në lëndën penale kundër;

KUJTIM SAHITI, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorit publik PP. Nr. 232/2007 të datës 24 shtator 2007, për veprën penale

- **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike** nga neni 229, paragrafi (2) i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës (KPPK),

MARKO JABLANOVIC, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorit publik PP. Nr. 232/2007 të datës 24 shtator 2007, të ndryshuar gojarisht nga Prokurori i EULEX-it në seancën gjyqësore me 3 dhe 4 maj, për këto vepra penale;

- **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike** nga neni 229, paragrafi (3), në lidhje me nenet 20 dhe 23 KPPK,
- **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve** nga neni 328 paragrafi (2) i KPPK

SLOBODAN KOSTOVIC, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorit publik PP. Nr. 232/2007 të datës 24 shtator 2007, të ndryshuar gojarisht nga Prokurori i EULEX-it në seancën gjyqësore me 3 dhe 4 maj, për këto vepra penale;

- **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229, paragrafi (3), në lidhje me nenet 20 dhe 23 KPPK,**

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datat 03 dhe 04 maj 2011, në praninë e të akuzuarve Kujtim Sahiti, Marko Jablanovic dhe Slobodan Kostovic, avokatëve të tyre të mbrojtjes Zeqir Maxhuni, Ljubomir Pantovic (të zëvendësuar nga Dejan Vasic me datën 04 maj 2011) dhe Xhafer Maliqi, dhe Prokurorit publik të EULEX-it Petr Klement, pas shqyrtimit dhe votimit të Trupit gjykues me 05 maj 2011, në bazë të nenit 392, paragrafi (1) i Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPP të K), me datën 05 maj 2011, e ka

shpallë publikisht në prezencën e të gjithë të akuzuarve, avokatëve të tyre dhe të Prokurorit publik këtë

AKTGJYKIM

I) I akuzuari **Kujtim SAHITI**, nuk ka nofkë, i biri i Bedri Sahiti dhe Shefkije Mirena, i lindur me 26 mars 1987 në Mitrovicë, Kosovë, Shqiptar, me banim në Vushtri, Rr. Adem Jashari, i pamartuar, pa fëmijë, jeton në bashkësi familjare me prindërit dhe dy motrat, pa të ardhura personale, arsimimi shkolla e administratës ligjore pa diplomuar, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, nuk ka shënime se është dënuar më parë, në paraburgim nga data 10 gusht 2007 deri me 30 gusht 2007, dhe në burgim shtëpiak nga data 31 gusht 2007 deri me 28 shtator 2007,

është

FAJTOR

- **sepse** me 09 gusht 2007 rreth orës 15:00, afër urës së trenit, te Kampi i Romëve në Mitrovicë ja ka shitur të akuzuarve Marko Jablanovic dhe Slobodan Kostovic 12 paketime me substancë narkotike të paketuara në qese plastike, me peshë totale neto 51,12 gram. Ekspertiza e ka vërtetuar se përbërja e qeseve ka qenë Marihuana (Cannabis) që përmban tetrahydrocannabinol (THC). I akuzuari nuk ka pasë autorizim për të shitur substanca narkotike.

Me këtë, i akuzuari **Kujtim SAHITI** ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale

Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229, paragrafi (2) i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës (KPPK);

II) I akuzuari **Marko JABLANOVIC**, me nofkën Divljak, i biri i Dragan Jablanovic dhe Snezana Milicevic, i lindur me 13 shkurt 1983 në Novi Pazar, me banim në Leposavic, rr. Dositea Obradovic, Serb, i pamartuar, pa fëmijë, të kryer shkollën e mjekësisë, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, më pari i dënuar për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve me Aktgjykim të plotfuqishëm të Gjykatës së qarkut të Mitrovicës K. Nr. 28/09, me 6 muaj burgim, data e kryerjes së kësaj vepre penale: 22 shkurt 2009, në paraburgim nga data 09 gusht 2007 deri me 30 gusht 2007 dhe në burgim shtëpiak nga data 31 gusht 2007 deri me 28 shtator 2007;

është

FAJTOR

- **sepse** me 09 gusht 2007 rreth orës 15:00, afër urës së trenit, te Kampi i Romëve në Mitrovicë, pa autorizim për blerje të substancave narkotike, ka blerë 6 qese plastike që përmbanin Mariuana (Cannabis) me peshë përafërsisht neto 25,5 gram nga Kujtim Sahiti. Ai ka pas qëllimin që vet ta përdorë drogën dhe të ja shpërndaj shoqërisë së tij.

Me këtë, i akuzuari **Marko JABLANOVIC** ka kryer dhe është përgjegjës për veprën penale

Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, nga neni 229, paragrafi (1) të KPPK,

III) gjithashtu i akuzuari **Marko Jablanovic**

është

FAJTOR

- **sepse** gjatë periudhës së panjohur të kohës e deri me 09 gusht 2007, pa autorizim ka qenë në posedim të 364 plumbave të kalibrit 7,62 dhe të një kanaçe me gaz lotsjellës të llojit M-3F që përmban substanca kimike të quajtura 'CS', të gjetura në veturën e tij pa tabela të regjistrimit me datën 09 gusht 2007.

Me këtë i akuzuari **Marko JABLANOVIC** ka kryer dhe është përgjegjës për veprën penale

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi (2) i KPPK;

IV) I akuzuari **Slobodan KOSTOVIC**, nofka Kosta, i biri i Jovica Kostovic dhe Vera Bozic, i lindur me 11 maj 1981 në Kraljevo, me banim në Leposavic, Rr. Ludaska 39, Serb, i pamartuar, nuk ka fëmijë, shkolla elektroteknike, jeton me prindërit dhe 5 vëllezër dhe motra, nuk ka të ardhura personale, e mbajnë prindërit, i gjendjes së varfër ekonomike, nuk ka shënime se është dënuar më parë, në paraburgim nga data 09 gusht 2007 deri me 30 gusht 2007, dhe në arrest shtëpiak nga data 31 gusht deri me 28 shtator 2007;

NUK ËSHTË FAJTOR

- **sepse** nuk është vërtetuar se ai me datën 09 gusht 2007, rreth orës 15:00, afër urës së trenit, te Kampi i Romëve në Mitrovicë, ka blerë 6 qese plastike që përmbanin Mariuana (Cannabis) me peshë përafërsisht neto 25,5 gram nga Kujtim Sahiti me qëllim që ato ti shes më teje apo ti distribuoj apo me qëllim që një pjesë të tyre ta eksportoje. Asnjë provë nuk ka mund të sfidojë deklaratën e tij se ai e ka ble drogën vetëm për përdorim personal.

Prandaj, në bazë të nenit 390 pika 3) e Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPPK) i akuzuari Slobodan Kostovic **lirohet nga akuza** për veprën penale

Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, nga neni 229, paragrafi (3) të KPPK.

I akuzuari **Kujtim Sahiti**

DËNOHET

me **dy /2/ vjet burgim dhe me dënim me gjobë prej pesëdhjetë /50/ Euro** për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike.

Dënimi me burgim **nuk do të ekzekutohet** po qe se i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër penale **gjatë një periudhe prej tre (3) vitesh** sipas nenit 44 Paragrafët (1), (2) dhe (4) të KPPK

Në rast të revokimit të dënimit me kusht, koha e kaluar në paraburgim nga 10 gusht 2007 deri me 30 gusht 2007 dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 31 gusht 2007 deri me 28 shtator 2007 do të konsiderohen si kohë e kaluar në burgim, në bazë të nenit 73 Paragrafi (1) i KPPK.

I akuzuari **Marko Jablanovic**

DËNOHET

- me një /1/ vit burgim dhe me gjobë prej pesëdhjetë /50/ Euro për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike

- me një /1/ vit burgim për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.

Dënimi unik përcaktohet të jetë **një /1/ vit e gjashtë /6/ muaj burgim dhe gjoba prej 50 Euro**, në bazë të nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) pika 2 e KPPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 09 gusht 2007 deri me 30 gusht 2007 dhe në burgim shtëpiak nga data 31 gusht 2007 deri me 28 shtator 2007 do të llogariten në dënim sipas nenit 73 Paragrafi (1) i KPPK.

Në bazë të nenit 229 Paragrafi (5) dhe nenit 60 Paragrafi (1) i KPPK konfiskohen 12 qeset plastike që përmbajnë një substancë nga bimët me ngjyrë të gjelbër, me peshë totale 51,12 gram, gjithashtu edhe dy telefona mobil (një Sony Ericson ngjyrë hiri, një Samsung kaltër-zi) të ndalura nga i akuzuari Marko Jablanovic .

Në bazë të nenit 60 Paragrafi (1) dhe nenit 328 Paragrafi (5) i KPPK, konfiskohen 364 plumbat të kalibrit 7,62, 2 copë zgjatëse të raketahedhësit dhe kanaçja e lotsjellësit të tipit M-3F.

Telefoni mobilo Motorola i zi, i konfiskuar nga i akuzuari Slobodan Kostovic do ti kthehet Slobodan Kostovic.

Të akuzuarit Kujtim Sahiti dhe Marko Jablanovic do ti kompensojnë pjesët e tyre të shpenzimeve të procedurës penale, në bazë të nenit 102 Paragrafi (1) i KPPK, përpos shpenzimeve të përkthimeve. Një aktvendimi i posaçëm në lidhje me vlerën e shpenzimeve të procedurës do të nxjerrët nga gjykata kur këto shënime të sigurohen, në bazë të nenit 100 Paragrafi (2) i KPPK.

Në bazë të nenit 103 Paragrafi (1) i KPPK shpenzimet e procedurës penale nga neni 99 Paragrafi (2) Nën-paragrafët 1 deri 5 të KPPK, shpenzimet e nevojshme për të akuzuarin Slobodan Kostovic dhe pagesa e avokatit dhe harxhimet e nevojshme të avokatit dhe gjithashtu shpenzimet për përkthime do të paguhën nga burimet buxhetore.

ARSYETIM

A. HISTORIA PROCEDURALE – AKTAKUZA

Aktakuza fillestare e Prokurorit të Qarkut PP. Nr. 232/2007 është bërë më 24 Shtator 2007 dhe është konfirmuar më 12 Nëntor 2007. Rasti është marrë përsipër nga Gjyqtarët e EULEX-it më 2 Dhjetor 2010.

Në pajtim me Nenin 376 Paragrafi 1 KPPK, Aktakuza është ndryshuar gojarisht dy herë nga Prokurori i EULEX-, përkatësisht në seancat e shqyrtimit kryesor gjyqësor të datës 3 dhe 4 Maj 2011. Në të dy rastet ndryshimet kishin të bënin me kualifikimin e veprës sipas

pikës së dytë të Aktakuzës. Sipas asaj pike në aktakuzën fillestare, të Akuzuarit Jablanovic dhe Kostovic janë akuzuar sipas Nenit 229, Paragrafi 1 lidhur me Paragrafin 4 Pika 1 dhe me Nenin 23 KPPK. Në seancën e datës 3 Maj Prokurori e ka ndryshuar aktakuzën duke hequr referimin në Paragrafin 4 Pika 1, dhe duke ruajtur akuzën ekskluzivisht sipas Nenit 229, Paragrafi 1 lidhur me Nenin 23 KPPK. Paragrafi 4 Pika 1 i referohet kryerjes së veprës si anëtar i një grupi; megjithatë grupi duhet të përbëhet prej së pakut tre personave, ndërsa në këtë rast vetëm të Akuzuarit Jablanovic dhe Kostovic janë të akuzuar sipas Nenit 229 Paragrafi 1. Më 4 Maj Prokurori gojarisht e ka ndryshuar këtë pikë të akuzës duke i akuzuar të Akuzuarit Jablanovic dhe Kostovic sipas Nenit 229, Paragrafi (3) lidhur me Nenin 20 dhe 23 të KPPK. Në përputhje me këtë Prokurori ka ndryshuar përshkrimin faktik të akuzës duke iu referuar deklaratave të dhëna nga të Akuzuarit Jablanovic dhe Kostovic në gjykatë se ata kishin për qëllim të shkonin në bregdet në Mal të Zi dhe të sillnin me vete së pakut një pjesë të marhuanës të cilën e kishin blerë nga i Akuzuari Sahiti.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/a është kompetente që ta shqyrtojë këtë rast në pajtim me Nenin 23 Pika 1) i) dhe Nenin 27 Paragrafi (1) i KPPK. Trupi gjykues përbëhet nga Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, Kryetare, dhe nga Gjyqtarët e EULEX-it Klaus Jung dhe Nikolay Entchev, anëtarë. Palët nuk patën amkesa lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

C. PËRMBLEDHJA E PROVAVE TË PREZENTUARA

Gjatë shqyrtimit kryesor gjyqësor u dorëzuan nga Prokurori Publik i EULEX-it dhe u evidentuan këto prova materiale:

1. Aktvendimi për konfirmimin e aktakuzës dhe procesverbali nga seanca e konfirmimit e datës 12 Nëntor 2007.
2. Kallximi Penal i datës 11 Gusht 2007
3. Raporti i Njësisë për deminim të KFOR-it Francez Nr. CR 61/25
4. Çertifikatat e Konfiskimit të datës 9 dhe 10 Gusht 2007
5. Raporti Fillestar i Incidentit i Datës 9 Gusht 2007
6. Kërkesa dhe Urdhëri për ekzaminimin e substancave të dyshuara narkotoke
7. Raporti i Ekzaminimit Kriminalistik Nr. 2007/1519 i datës 20 Gusht 2007
8. Shkresa zyrtare e datës 10 Gusht 2007, nënshkruar nga Mehmet Terbunja – Zyrtar Policor, e lexuar me pëlqimin e palëve

Gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor më 3, 4 dhe 5 Maj, tre të Akuzuarit dhanë deklaratat dhe u përgjigjën në pyetje.

D. VLERËSIMI I DËSHMIVE TË PREZENTUARA

Gjykata konstatoi se përshkrimi faktik i lëndës penale siç përshkruhet në dispozitiv është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar me dëshmitë e vlerësuara më poshtë.

Në dëshmitë e tyre në Gjykatë, të Akuzuarit Jablanovic dhe Kostovic dhanë një vlerësim për takimin e parë të tyre me të Akuzuarin Sahiti dhe se si janë rënë në kontakt me të si furnizues i mundshëm i marihuanës. Sipas dëshmisë së Jablanovicit, ai dhe Kostovici e kishin takur Sahitin për herë të parë me rastin e dyluftimit të qenëve të organizuar në pjesën veriore të Mitrovicës; në këtë rast Sahiti i kishte ofruar Jablanovicit një sasi të vogël marihuanë (që mjaftonte për një cigare) dhe ia kishte dhënë atij numrin e telefonit mobil. Gjykata, për arsyet që do të spjegohen më poshtë, e merrë si të besueshme dëshminë e Jablanovicit sa i përket këtij dhe aspekteve tjera. Gjithashtu, takimi me rastin e dyluftimit të qenëve dhe fakti që Jablanovici kishte marrë numrin e Sahitit konfirmohen nga Kostovici në dëshminë e tij. Kostovici gjithashtu ka deklaruar se ai kishte mësuar nga Jablanovici se ata mund të blenin marihuanë nga Sahiti, pohim ky që është konsistent me dëshminë e Jablanovicit. Madje edhe Sahiti ka konfirmuar se ishte takuar me Jablanovicin dhe Kostovicin me rastin e dyluftimit të qenëve dhe se ia kishte dhënë numrin e telefonit, megjithëse ka deklaruar se numrin ia ka dhënë Kostovicit e jo Jablanovicit. Në anën tjetër, Sahiti kategorikisht ka mohuar se u ka ofruar drogë dy të Akuzuarëve tjerë. Megjithatë, Gjykata, për arsyet që do ilustrohen më poshtë, nuk e konsideron dëshminë e tij si të besueshme sa i përket këtij aspekti si dhe aspekteve tjera.

Rrethanat lidhur me takimin e parë ofrojnë një bazë logjike dhe sqarim të ngjarjeve që pasojnë. Me 09 Gusht 2007, të Akuzuarit Jablanovic dhe Kostovic po udhtonin nga Leposavici në Mitrovicë në një Fiat Coupé të Jablanovicit. Qëllimi i tyre ishte të blenin ca marihuanë para se të niseshin, të njëjtën ditë, për në bregdetin e Malit të Zi ku po i pritnin disa shokë nga Serbia. Jablanovici planifikonte që ta konsumonte marihuanën bashk me shokët e tij në bregdet. Që të dytë, Jablanovici dhe Kostovici janë konsumues të zakonshëm të marihuanës. Për këto arsye ata thirrën Sahitin dhe e lutën që të takoheshin në Mitrovicë për të blerë nga ai një sasi marihuan në barazvlerë të 20 Eurove. Jablanovici dhe Kostovici donin ta ndanin marihuanën në pjesë të barabarta.

Pasiqë Sahiti u pajtua në telefon që tua shiste marihuanën, ai iu tha atyre që të takoheshin afër urës së trenit në pjesën jugore të Mitrovicës. Pasi parkuan veturën afër kampit të Romëve në Mitrovicë, Jablanovici dhe Kostovici kaluan urën në këmbë dhe arritën në lokacionin ku ishin marrë vesh. Pasiqë Sahiti nuk ishte akoma aty ata e thirrën në telefonin e tij mobil disa herë për të parë nëse po vinte. Sahiti arriti pas një kohe (30 minuta deri në një orë) bashk me dy persona tjerë të cilët Jablanovici dhe Kostovici nuk i njihnin. Sahiti u dha atyre marihuanën e paketuar në 12 qese plastike me peshë të përgjithshme neto 51,12 gram. Qeset ishin brenda në një shishe plastike.

Duke e bartur me vete shishen e plastikës në të cilën gjindej marihuana, Jablanovici dhe Kostovici kaluan urën e hekurudhës në këmbë, arritën tek vetura, dhe pasi vozitën veturën në një distancë të shkurtër, ata i ndali policia rreth orës 15:00h. Gjatë një

kontrollimi në veturë, policia gjeti shishen me qeset e marihuanës dhe, në bagazhin e veturës, policia gjeti 364 fyshek të kalibrit 7,62, 2 pjesë vazhduese të një lansuesi raketash dhe një kanaçe gazi lotsjellës të tipit M-3F e cila përmbante lëndë kimike të quajtur 'CS'. Gjësendet në bagazh i përkisnin Jablanovicit.

Këto të dhëna lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur më 9 Gusht 2007 bazohen në këto dëshmi: dëshmitë e dhëna në Gjykatë nga Jablanovici dhe Kostovici; deklaratat e personit të parë të dhëna në Polici dhe prokurori më 10 Gusht 2007 përkatësisht më 21 Gusht 2007 dhe nga personi i dytë dhënë në polici dhe në prokurori më 10 Gusht 2007 përkatësisht më 21 Gusht 2007; konstatimet lidhur me marihuanën e konfiskuar e cila ceket në Raportin e Ekzaminimit Kriminalistik të datës 10 Shtator 2007 (shih faqet 91-94 në shkresat e lëndës së Prokurorit); Raporti Kriminalistik i datës 11 Gusht 2008 i parashtruar nga Policia e Kosovës kundër tre të Akuzuarëve (shih faqet 39-42 të shkresave të lëndës të Prokurorit); Raporti i Njësisë së KFOR-it Francez për Deminim Nr. No. CR 61/25, duke përfshirë dëshmitë fotografike të drogës dhe të gjësendeve tjera të gjetura në veturë (shih faqet 43-59 në shkresat e lëndës së Prokurorit); çertifikata mbi konfiskimin e marihuanës dhe gjësendeve tjera të gjetura në veturë (shih faqet 60-61 në shkresat e lëndës së Prokurorit).

Sa i përket vlerësimit të këtyre dëshmimeve, duhet thënë se dëshmitë e të Akuzuarëve Jablanovic dhe Kostovic kryesisht përputhen dhe janë gjithashtu konsistente me deklaratat e dhëna nga ata në Polici dhe Prokurori. Duhet vënë re se derisa të dy të Akuzuarit në dëshmitë e tyre (si në Gjykatë poashtu edhe në fazën e hetimit) kanë cekur se sasia e marihuanës që kanë marrë ishte e ndarë në 10 qese, në Raportin e Ekzaminimit Kriminalistik të datës 10 Shtator 2007 (shih faqet 91-94 në shkresat e lëndës së Prokurorit) ceket se kanë qenë 12 qese. Kjo mospërputhje spjegohet lehtë pasi që të Akuzuarëve mund të mos u kujtohet mirë apo se kanë menduar se ishin 10 qese, sidomos kur të kihet parasysh se qeset mbaheshin në një shishe plastike dhe prandaj nuk shifeshin qartë. Gjykata, në fakt, nuk ka gjetur asnjë dëshmi që dy të Akuzuarit t'i kenë thënë Sahitit që tua shiste marihuanën të ndarë në qese të vogla. Dëshmitë e të Akuzuarëve Jablanovic dhe Kostovic tregojnë në mënyrë konsistente se ata kishin kërkuar nga ai marihuanë në barazvlerë të 20 eurove. Kjo është me rëndësi sepse aktakuza pretendon që Jablanovici dhe Kostovici kanë kërkuar nga Sahiti t'ua paketojë marihuanën në qese të vogla me qëllim që të dëshmojnë synimin e tyre për ta ri-shitur apo shpërndarë drogën.

Në të vërtetë, dëshmia e vetme sa i përket kësaj është pranimi i Jablanovicit në Gjykatë se ai planifikonte ta konsumojë marihuanën që e kishte blerë nga Sahiti bashk me shokët e tij në bregdet. Ai gjithashtu ka deklaruar se ai nuk do t'ua shiste atyre drogën por se do ta konsumonte bashk me ta pa pagesë. Edhe pse ky fakt vendimtar nuk është përmendur në deklaratat e Jablanovicit në fazën e hetimit, duhet vënë re se gjatë marrjes në pyetje, atij nuk iu është bërë pyetje eksplicite nëse ai planifikonte ta konsumonte marihuanën bashk me dikend tjetër apo jo. Sa i përket Kostovicit, ai vazhdimisht ka deklaruar, në gjykatë dhe gjatë deklaratave të tijë në fazën e hetimit, se ai planifikonte që ta merrte vetëm një pjesë të drogës me vete, vetëm për nevoja personale, derisa pjesën tjetër do ta mbante në shtëpi në Laposavic për konsumim personal në të ardhmen.

Derisa Gjykata i beson dëshmisë së Jablanovicit lidhur me synimin e tij për ta ndarë me dikend tjetër marihuanën, ajo ka disa dyshime sa i përket vërtetësisë së deklaratës së Kostovicit se ai do ta përdorte marihuanën ekskluzivisht për vete. Sidoqoft, fakti se ai po shkonte në pushim bashkë me Jablanovicin dhe do të bashkohej shoqërisë së njejtë ku prezumohet se do të përdorej marihuana, nuk mund të mirret si dëshmi e mjaftueshme për të konkluduar se synimi i tij ishte ndarja e marihuanës me persona tjerë. Poashtu, sasia e marihuanës të cilën e kishte blerë, si e tillë, nuk mjafton për të ardhur në përfundim lidhur me synimin e tij për ta shitur apo shpërndarë drogën. Andaj, nuk ka dëshmi të mjaftueshme për ta mbështetur ndonjë pretendim se ai e kishte blerë drogën me qëllim që ta ri-shiste apo shpërndante atë më tutje.

Një çështje tjetër kyçe ka të bëjë me identifikimin e Sahitit nga ana e Jablanovicit dhe Kostovicit. Në dëshmitë e tyre ata kanë deklaruar se, kur e kanë takuar Sahitin, nuk e kanë ditur emrin dhe mbiemrin e tij por vetëm nofkën e tij "Kujto". Duke patër këtë parasyshë, prova lidhur me identifikimin e Sahitit nga dy të Akuzuarit si person të cilin së pari herë e kishin takuar tek dyluftimi i qenëve dhe pastaj ua kishte shitur atyre marihuanën, bëhet veçanërisht e rëndësishme. Dëshmia e Jablanovicit dhe Kostovicit lidhur me identifikimin e tyre për Sahitin, që kishte ndodhur në Qendrën e Policisë Rajonale në Mitrovicë, konfirmohet nga shkresa zyrtare e zyrtarit policor të Kosovës Mehmet Terbunja e datës 10 Gusht 2007. Në këtë shkresë, Z. Terbunja ka shkruar se policia e kishte kapur të Akuzuarin Kujtim Sahiti me datën 10 Gusht 2007 mbi bazën e përshkrimit fizik që ishte bërë nga Jablanovici. Jablanovici ka cekur posaqërisht shenjën e kuqe të lindjes të Sahitit në krahun e tij të majt. Në stacionin policor, që të dytë, Jablanovici dhe Kostovici e kanë njohur Sahitin si personi me nofkën "Kujto" i cili ua kishte shitur atyre marihuanën një ditë më parë. Duhet shtuar se Gjykata, gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka vërtetuar ekzistencën e shenjës së lindjes së Sahitit, pasi i Akuzuari vetë e tregoi atë në Gjykatë.

Sa i përket besueshmërisë së gjithmbarshme të dëshmisë së të Akuzuarit Jablanovic, Gjykata konstaton se aji ishte e besueshme për këto arsye: ajo përputhet me deklaratat e maparshme të tij të dhëna gjatë fazës së hetimit; i Akuzuari, veçanërisht me pranimin e fajësisë për akuzën që ka të bëjë me posedimin e armëve dhe me pranimin e synimit të tij që drogën ta ndante me shokët e tij, ka shfaqur qëllimin e qartë për ta treguar të vërtetën gjatë dëshmisë së tij, pamarrë parasyshë nëse kjo do të kishte efekte negative në rastin e tij. Është e vërtetë se Jablanovici ka cekur se ishte rrahur nga Policia gjatë marrëjes së tij në pyetje. Megjithatë, pamarrë parasyshë nëse kjo është e vërtetë apo jo, Jablanovici ka konfirmuar në Gjykatë se, përkundër rrahjeve, ai ia kishte thënë të vërtetën policisë lidhur me ngjarjet e datës 9 Gusht. Pastaj, dëshmia e Kostovicit përputhet me atë të Jablanovicit pa mospërputhje të mëdha.

Në anën tjetër, Gjykata nuk e gjeti të besueshme dëshminë e Sahitit, i cili e mohoi t'u ketë shitur marihuanë dy të Akuzuarëve tjerë në ditën kritike apo në ndonjë rast tjetër. Gjykata beson se deklaratat e tij janë të qartazi të motivuara për ta shfajësuar veten. Nuk është e besueshme, sidomos, se Kostovici, siç kishte deklaruar në dëshminë e tij Sahiti, do të kishte thënë atij në burg se ai (Kostovici) dhe Jablanovici ishin detyruar që ta tregonin atë (Sahitin) si furnizues i marihuanës. Nuk është në të vërtetë e qartë pse

Kostovici do tia bënte këtë “ rrëfim ” sidomos kur kihet parasyshtë se këta të dy nuk kishin shoqëri mes veti, sipas versionit të fakteve të Sahitit, ata në në të vërtetë ishin takuar vetëm me rastin e dyluftimit të qenëve në Mitrovicë.

E. Kalifikimi Ligjor

Veprimet kriminale janë kryer në Gusht të vitit 2007. Në atë kohë, ligji i aplikueshëm ishte Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale (KPPK). Sipas Nenit 2, Paragrafi (1), I ligjit në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të aplikohet për kryerësin.

I Akuzuari Sahiti është akuzuar dhe shpallur fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, nga neni 229, paragrafi (2) të KPPK, i cili thotë:

Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.

Vendimi mbi Formimin e Listës së Narkotikëve¹ e përcakton substancën tetrahydrocannabinol (THC) si narkotik. Raporti i Ekzaminimit Kriminalistik i datës 10 Shtator 2007 tregon se marihuana e gjetur në veturën e Jablanovicit përmban THC. Sipas fakteve të dhëna më lartë, Sahiti u ka shitur dy të Akuzuarëve tjerë 51.12 gram marihuan për çmimin prej 20 Euro; duke shitur drogën ai ka kryer vepër sipas dispozitës së lartcekur.

Të Akuzuarit Jablanovic dhe Kostovic janë akuzuar si bashk-kryerës duke tentuar ta kryejnë veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, nga neni 229, paragrafi (3) i KPPK, i cili thotë:

Kushdo që paautorizim eksporton ose importon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope dënohet me gjobë dhe burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

Gjykata ka ri-kalifikuar akuzën kundër të Akuzuarit **Jablanovic** dhe e ka dënuar atë sipas Nenit 229 Paragrafi (1) i KPPK i cili thotë:

¹ No. 1094, Federal Executive Council, 21 December 1978.

Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim shitje, shpërndarje ose ofron për shitje substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë dhe substance psikotropike dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në pesë vjet.

Gjykata nuk ka konstatuar se sjellja e të Akuzuarit Jablanovic mund të kualifikohet sipas Nenit 229 Paragrafi (3) siç propozohet nga Prokurori. Në të vërtetë, synimi kryesor i shprehur nga i Akuzuari që ta sjellur marihuanën në Mal të Zi nuk është i mjaftueshëm për ta kualifikuar sjelljen e tij si tentim për ta eksportuar drogën në Mal të Zi. Sipas Nenit 20 të KPPK, i cili e përkufizon “tentimin”, në vend të kësaj kërkohej një veprim i drejtpërdrejtë për të eksportuar drogë. Ky veprim i drejtpërdrejtë do të kishte ndodhur në rast se, për shembull, Jablanovici do të ishte kapur me drogë nga Policia duke iu afruar apo duke tentuar ta kalojë kufirin. Në rastin konkret, në vend të kësaj, i Akuzuari është ndalur dhe arrestuar nga policia gjersa akoma ishte në Mitrovicë, pakë minuta pasi që kishte blerë drogën.

Në vend të kësaj, Gjykata ka shpallur të Akuzuarin Jablanovic fajtor sipas Nenit 229 Paragrafi (1) pasiqë, sipas fakteve të cekura më lartë, ai ka blerë gjysmën e marihuanës së gjetur në veturën e tij (peshë neto rreth 25,5 gram) nga Kujtim Sahiti dhe ka patur për synim që jo vetëm ta konsumojë drogën, por edhe t’ua shpërndajë atë shokëve të tij në Mal të Zi.

I Akuzuari Jablanovic është akuzuar dhe shpallur fajtor edhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 paragrafi (2) i KPPK i cili thotë:

Kushdo që mban në pronësi, kontrollon, posedon ose përdor armë pa lejen valide për mbajtjen e autorizuar të armëve për atë armë, dënohet me gjobë deri në 7.500 euro ose me burgim prej një deri në tetë vjet.

- Gjykat e ka pranuar pranimin e fajësisë në këtë akuzë të dhënë nga Jablanovici në seancën gjyqësore të datës 3 Maj 2011. Kjo ka krijuar plotësimin e kërkesave sipas Nenit 315 Paragrafi 1 i KPPK. Raporti i Njësisë së KFOR-it Francez për Deminim Nr. CR 61/25 tregon se kanaçja me gaz lotsjellës të llojit M-3F përmban substanca kimike të quajtura ‘CS’, që numërohet si armë sipas Nenit 107 Paragrafi 28 KPPK. Sa u përket fyshekëve të kalibrit 7,62, është e vërtetë se, siç argumentohet nga mbrojtja e Jablanovicit, nuk ka dëshmi, si psh.ekspertizë balistike, se fyshekët ishin funksional dhe jo të ndryshkur dhe të papërdorshëm. Megjithatë, sipas Nenit 107 Paragrafi 28, përkufizimi për “armë” përfshinë instrumentet, përfshirë të gjitha llojet e municionit, të dedikuar për të shkaktuar lëndime trupore, dmth. Pamarrëparasyshë nëse ato janë akoma funksionale apo jo. Gjykata nuk i ka konsideruar si armë dy pjesët e lansuesit të raketave, pasiqë ato janë vetëm pjesë të armës. Megjithatë, për shkaqe sigurie, Gjykata ka vendosur që t’i konfiskojë edhe ato.

I Akuzuari Kostovic, në anën tjetër nuk është shpallur fajtor sepse, në bazë të fakteve të dhëna më lartë, nuk është vërtetuar se ai e ka blerë marihuanën me qëllim që ta ri-shes apo shpërndajë atë më tutje apo që ai ka tentuar ta eksportojë drogën. Neni 229 i KPPK, në të vërtetë nuk e penalizon blerjen e drogës për konsumim personal.

F. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

Kur të shqipton dënimin penal, Gjykata duhet ta ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit- të ndalojë aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke frenuar të tjerët që të mos kryejnë veprime të ngjajshme kriminale- dhe qëllimin specifik- ta parandalojë kryesin e veprës që të mos përsërisë veprën. Në rastin konkret, Trupi Gjykues erdhi në përfundim se vetëm me shqiptimin e dënimit me burg do të arrihet qëllimi i dyfishtë i lartcekur.

Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit, Gjykata duhet t'i vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, në pajtim me Nenin 64 Paragrafi (1) i KPPK, duke mbetur brenda kufijëve të dënimit të paraparë me ligj.

Gjykata i ka dënuar të Akuzuarit Sahiti dhe Jablanovic për veprat penale sipas Nenit 229 të KPPK me dënimet që gjinden në rangun e poshtëm të dënimit përshkruar sipas ligjit, përkatësisht: dy vite dënim me burg për të Akuzuarin Sahiti, dhe një vit burgim për Jablanovicin dhe me nga një gjobë prej 50 euro për secilin. Vlera e mbrojtur me atë dispozitë është që të mbrohet shoqëria nga përhapja e drogës, përdorimi i të cilave ka efekte të rrezikshme në shëndetin e individëve dhe në rendin dhe vlerat shoqërore. Në rastin konkret, Gjykata mori në konsiderim shumën modeste të drogës e cila ishte shitur dhe faktin se THC apo kanabisi, edhe pse i përcaktuar si narkotik, konsiderohet drogë me potencial të ultë të dëmtimit të shoqërisë.² Si përfundim intensiteti i rrezikut të vlerës së mbrojtur është vlerësuar i ultë dhe prandaj nuk kërkon dënim më të ashpër. Gjoha minimale prej 50 euro është shqiptuar gjithashtu duke patur parasysh gjendjen e dobët ekonomike të të dy të Akuzuarëve.

Duke patur parasysh se i Akuzuari Sahiti nuk ka qenë ndonjëherë më parë i dënuar dhe se nuk ka indikacione se në katër vitet e fundit ka patur konflikt me Ligjin, Gjykata vendosi ta pezullojë dënimin me burg ndaj tij sipas Nenit 44 Paragrafi (1), (2) dhe (4) i KPPK.

Sa i përket të Akuzuarit Jablanovic, Gjykata i shqiptoi dënimin minimal prej një viti burgim për veprën - Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi (2) i KPPK.

Gjykata vendosi kështu duke pasur parasysh nivelin e ultë të rrezikshmërisë së armëve të gjetura në posedim të tij. Fotografitë e fysishekëve të pranuar si dëshmi, në veçanti, duket

² Sa i përket rrezikshmërisë shoqërore të kanabisit shih *Raportin e Komisionit Global mbi Çështjen e Drogës*, Qershor 2011 f. 12 ku citohet punimi shkencor i Nutt, D., King, L.A., Saulsbury, W. and Blakemore, C. (2007) "Zhvillimi i një shkalle racionale për të vlerësuar dëmin e drogave nga keqpërdorimi i mundshëm" *Lancet* Vol. 369 (9566) pp.1047-53. Studimi rendit kanabisin në nivel më të ultë që drogat aktuale dhe të mundshme mund të shkaktojnë dëme për shoqërinë dhe në një nivel shumë më të ultë të rrezikut, se sa, heroina kokaina apo alkoholi.

se tregojnë që fyshekët ishin bukur të ndryshkur, fakt ky që është deklaruar edhe nga Jablanovici në dëshminë e tij në gjykatë.

Si rrjedhojë, Gjykata i shqiptoi Jablanovicit dënimin unik prej një vit e gjashtë muaj burgim sipas Nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 e KPPK. Gjykata, megjithatë, nuk e konsideroi të përshtatshme pezullimin e dënimit në këtë rast. Kjo për shkak të sjelljes paraprake kriminale të tij; përkatësisht më 7 Dhjetor 2009 Gjykata e Qarkut në Mitrovicë e ka dënuar Jablanovicin me aktgjykim të formës së prerë me gjashtë muaj burgim për -Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragrafi (2) i KPPK.

G. Gjësendet e Konfiskuara

12 qese plastike që përmbanin substancë bimësh ngjyrë të gjelbërt, me pesh totale prej 51,12 gram, si dhe dy telefona mobil (një Sony Ericson ngjyrë hiri, një Samsung ngjyrë e kaltër- zezë) të marrura nga Akuzuari Marko Jablanovic janë konfiskuar sipas Nenit 229 Paragrafi (5) dhe Nenit 60 Paragrafi (1) i KPPK.

364 fyshekët e kalibrit 7,62, 2 pjesët e lansuesit të raketave dhe kanaçja e gazit lotsjellës e tipit M-3F janë konfiskuar sipas Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Neni 328 Paragrafi (5) i KPPK.

Telefoni i zi mobil Motorola i marrur nga i Akuzuari Slobodan Kostovic do t'i kthehet Slobodan Kostovicit pasi që ai është liruar nga aktakuza.

H. Shpenzimet

Pasi janë dënuar, Të Akuzuarit Kujtim Sahiti dhe Marko Jablanovic do t'i kompenzojnë pjesët e tyre të shpenzimeve të procedurës penale sipas Nenit 102 Paragrafi (1) i KPPK përveç shpenzimeve të përkthimit gojor dhe me shkrim. Një aktvendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të lëshohet nga gjykata kur të sigurohen këto të dhëna sipas Nenit 100 Paragrafi (2) i KPPK.

Për shkak të lirimit nga aktakuza e Slobodan Kostovic, sipas Nenit 103 Paragrafi (1) i KPPK, shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 99 Paragrafi (2) Nënparagrafi 1 deri 5 i KPPK, shpenzimet e nevojshme të të Akuzuarit Slobodan Kostovic dhe kompenzimi i shpenzimeve të nevojshme për mbrojtjen e tij, si dhe shpenzimet e përkthimit gojor dhe me shkrim do të paguhet nga burimet buxhetore.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/a
K. nr. 244/2007

Përgadituar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Francesco de Sanctis
Procesmbajtës

Hajnalka Veronika Karpati
Kryetare e Trupit Gjykses

Këshillë Jjuridike:

Personat e autorizuar mund të parashetrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/a brenda afatit prej pesëmbdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të kopjes së këtij aktgjykimi, sipas Nenit 398 Paragrafi (1) i KPPK.